



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 3
02.10.2013

NR. VENDIMI 9
09.05.2014

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, e formuar në kolegji, sipas kërkesave të nenit 7, pika 2 të ligjit nr. 10 192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” dhe shortit të datës 03.10.2013, nga gjyqtarët:

Nertina	KOSOVA	KRYESUES
Klodian	KURUSHI	ANËTAR
Gurali	BRAHIMLLARI	ANËTAR

asistuar nga sekretarja **Blerina Sukaj**, në Tiranë, në disa seanca gjyqësore publike dhe e fundit sot në datë 09.05.2014, ora 12.30 mori në shqyrtim, çështjen nr. 3/12 akti që i përket:

PADITËSE: Prokuroria Për Krime Të Rënda Tiranë, e përfaqësuar nga prokurori i Prokurorisë së Apelit për Krime të Rënda, z. **Edvin Kondili**.

TË PADITUR: D.L., i biri i V. dhe i D., i dtl. xxx, lindur ne xxx dhe banues ne xxx, Rr. xxx, Pall.xxx Shk. x, Ap.x, xxx, me prani të mbrojtësit B.L. me Nr.xxx License me adresë Rr. xxx, Pall.xxx, Shk. x, Ap.x, xxx, identifikohet me karte identiteti me nr.Personal xxx.

OBJEKTI: I. Konfiskimi i pasurive të mëposhtme: - *Pasurisë pranë Bankës xxx të xxx dhe me konkretisht:*

- Llogaria me nr. xxx ne shumen xxx leke.
- Llogaria me nr. xxx ne shumen xxx USD
- Llogaria me nr. xxx ne shumen xxx euro
- Llogaria me nr. xxx ne shumen xxx euro.
- Të shumës prej xxx euro dhe xxx lekesh që gjenden ne Bankën xxx, me nr llogarie xxx, xxx dhe në Bankën xxx me nr llogarie xxx.

II. Për Administrimin dhe përdorimin e pasurive të paluajshme ngarkohet z.K.Xh., administrator i Agjencisë për Administrimin e pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë.

III. Për ekzekutimin e këtij vendimi ngarkohet Zyra e Përmbartimit, xxx.

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 10 192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Në bisedimet përfundimtare, palët kërkuan:

Pala paditëse, përfaqësuar nga prokurori Edvin Kondili:

I. Konfiskimin e pasurive: Pasurisë pranë Bankës xxx dhe me konkretisht :

-Llogaria me nr. xxx ne shumen xxx leke.

-Llogaria me nr. xxx ne shumen xxx USD

-Llogaria me nr. xxx ne shumen xxx euro

-Llogaria me nr. xxx ne shumen xxx euro.

-Të shumës prej xxx euro dhe xxx lekesh që gjenden ne Bankën xxx, me nr llogarie xxx, xxx dhe në Bankën xxx me nr llogarie xxx.

II. Për Administrimin dhe përdorimin e pasurive të paluajshme ngarkohet z.K.Xh., administrator i Agjencisë për Administrimin e pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë.

III. Për ekzekutimin e këtij vendimi ngarkohet Zyra e Përmbartimit, xxx.

IV. Shpenzimet procedurale të kryera gjatë hetimit si dhe shpenzimet gjyqësore ti ngarkohen të hetuarit/paditurit D.L.

Pala e Paditur D.L. në prani të mbrojtësit të tij Av.B.L., kundërshtuan pretendimet e Prokurorisë për Krime të Rënda e kërkuan:

Në përfundim të bisedimeve përfundimtare: “Rrëzimin e padisë së ngritur nga prokuroria për konfiskimin e pasurisë dhe revokimin e sekuestros ne referim te ligjit 10192 datë 03.12.2009, si dhe u kërkuu që Gjykata të shprehet në lidhje me rregullimin e pasojave që i janë shkaktuar pasurisë nga mosadministrimi i saj, në referim te pikës 4 të nenit 20 te ligjit Nr 10192 datë 03.12.2009 “Per parandalimin dhe goditjen e Krimit te organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Gjykata, si dëgjoji pretendimet përfundimtare të palëve si më sipër, shqyrtoi dhe analizoi provat e paraqitura prej tyre e të debatuar në seancë gjyqësore, si dhe pasi vlerësoi çështjen në tërësi;

V Ë R E N se:

I. Rregjistrimi i kërkesës për konfiskim në gjykatë, legjitimimi i palëve.

Me kërkesën objekt gjykimi, e regjistruar me datë xxx nga Prokuroria për Krime

të Rënda Tiranë, mbi bazën e ligjit 10192, datë 03.12.2009, “Per parandalimin dhe goditjen e Krimet te organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” kërkohet konfiskimi i pasurive të mëposhtme:

Pasurisë pranë Bankës xxx dhe me konkretisht : Llogaria me nr. xxx ne shumen xxx leke.

Llogaria me nr. xxx ne shumen xxx USD Llogaria me nr. xxx ne shumen xxx euro Llogaria me nr. xxx ne shumen xxx euro.

Të shumës prej xxx euro dhe xxx lekesh që gjenden ne Bankën xxx, me në llogarie xxx, xxxdhe na Bankën xxx me nr llogarie xxx.

Rezulton se me date xxx ne sekretarine e kesaj Gjykate është depozituar per gjykim kërkesa-Kunder-Padi nga D.L., me objekt’’Revokimin e vendimit Nr xx date xxx te Gjykates se Shkalles së Parë per Krime te Renda, mbi procedimin pasuror nr xxx, bazuar ne Nenin 160 te K.Pr.Civile, neni 13 i ligjit nr 10192 date 03.12.2009’’ Per parandalimin dhe goditjen e krimet te organizuar dhe trafikimit nepermjet masave parandaluese kunder pasurise’’ dhe me vendimin e datës xxx kjo Gjykate vendosi:’’ Rrëzimin e kërkesës për shqyrtimin e Kundër-Padisë për shkak se është e pambështetur në ligj e kthimin e akteve, duke lejuar dhe ankimin ndaj këtij vendimi bashkë me vendimin përfundimtar në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë’’.

I. Rrethanat e çështjes

1. Nga aktet e përfshira në fashikullin e gjykimit të kërkesëpadisë dhe gjatë gjykimit të çështjes në këtë gjykatë rrethanat e faktit paraqiten si vijon: Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë (prokuroria) në datë xxx, ka regjistruar procedimin pasuror nr. xx, në ngarkim të personit të dyshuar (të paditurit) D.L.

2. Emri i të paditurit D.L., ne regjistrin e veprave penale eshte regjistruar më datë 15.05.2012 dhe ai është dyshuar e më pas akuzuar nga Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë, për kryerjen e veprave penale të: “Trafikimit të narkotikëve” në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283/a/2 të K.Penal.

Procedimi penal eshte regjistruar mbi bazen e referimit te Drejtorise kunder Krimet te Organizuar ne Drejtorine e Pergjithshme te Policise se Shtetit, sipas te cilit ka rezultuar se policia shqiptare eshte njoftuar nepermjet oficerit te kontaktit xxx ne Shqiperi se ne date xxx rreth ores xxx se ne nje shesh pushimi te autostrades xx ne xxx te xxx, xxx eshte ndaluar nga dogana xxx e xxx shtetasi K.K., i dtl xxx duke udhetuar me kamion me targa xxx dhe xxx. Ne murin ballor te te rimorkios se mjetit jane gjetur dhe sekuestruar xxx pako te nje sasie lende narkotike ne masën prej xxx (xxx) kg e llojit marijuane.

Pas kapjes se tij nga autoritetet xxx, duke bashkepunuar, ka deklaruar e eshte bere mundur te kryhen disa telefonata ne drejtim te shtetasve porosites te rruges se tij, duke bere te mundur keshtu dhe identifikimin e personave shqiptare te implikuar ne kete ngjarje dhe te cilet i kishin premtuar se do ta ndihmonin per te ndrequr ‘’defektin’’ qe i kishte ndodhur me automjetin atje per te cilin i duheshin xxx euro. Nga personat qe kishte kontakte ne Shqiperi, shtetasit te hetuar K.K. po i ushtrohej presion mbi te dhe familjaret e tij qe ti dorezonte kamionin.

Keshtu, ne kerkesen per gjykim e urdheri per regjistrimin e procedimit penal,

pasqyrohet se qe nga data xxx, qe eshte regjistruar procedimi penal prane kesaj Prokurorie, jane kryer veprime mbi identifikimin e te dyshuarve si autore te kesaj vepre penale dhe jane autorizuar pergjime telefonike per numrat qe eshte dyshuar se perdoren nga te implikuarit ne kete veper penale, nga ku me pas **jane identifikuar shtetasit D.L.; O.T. e A.C.**

Me konkretisht, sipas akuzes dhe kerkeses per gjykim, pjese e ketij fashikulli, keta shtetas jane te implikuar ne ngjarjen e dates xxx, ku ne xxx eshte arrestuar shtetasi K.K. dhe ne kamionin qe ai drejtonte eshte gjetur dhe sekuestruar nje sasi lende narkotike prej xxx (xxx) kg e llojit Cannabis Sattiva.

Me date xxx pas mberritjes se materialeve nga autoritetet gjermane te drejtesise **eshte bere regjistrimi i emrave te personave te cileve u atribuohet vepra penale e "Trafikimit te narkotikeve", ne bashkepunim parashikuar nga neni 283/a/2 i Kodit Penal shtetasve D.L., O.T. dhe A.C.**

Pra rezulton e provuar se ndaj ketyre personave eshte regjistruar procedimi penal Nr xxx nga Prokuroria per Krime te Renda Tirane dhe eshte sjelle per gjykim ne po kete gjykate me akuzen lartpërmendur dhe me vendimin nr xx datë xxx të Gjykatës së Shkallës së Parë është vendosur ndër të tjera dhe: "Deklarimi fajtor i të pandehurit D.L. për kryerjen e veprës penale të "Moskallëzim të krimit" parashikuar nga neni 300, paragrafi I parë I Kodit Penal dhe dënimin e tij me x(xx) vjet burgim, e ndërsa nuk është shprehur mbi vlerat monetare te sekuestruara në banesë prej xxx euro dhe xxx lekë në referim të nenit 190 pika 1 germa 'c' e Kodit të Procedurës Penale, në kushtet kur, gjykata me vendim nr xx datë xxx për këto shuma kishte vendosur sekuestro ne bazë të Ligjit të posacëm nr 10192 datë 03.12.2009.

Me vendimin nr xx datë xxx të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë është vendosur ndër të tjera: "Lënia ne fuqi e vendimit Nr xx datë xxx të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë".

3. Kjo Gjykatë vëren se vepra penale e mësipërme, për të cilën është dyshuar e akuzuar i hetuari, në kohën e kryerjes së saj e aktualisht, parashikohet si krim, sipas ligjit tonë penal material, si: "**Trafikimi i lëndëve narkotike**", kryer në bashkëpunim (nenet 283/a-2 të Kodit Penal).

4. Për të gjykuarin D.L., nga vendimi lartpërmendur provohet se ai është deklaruar fajtor për veprën penale të "Moskallëzim të krimit" në bazë të nenit 300/1 të Kodit Penal, i dënuar tashmë në dy shkallët e gjykimit, për veprën penale të cituar më lart.

5. Rezulton te provohet se veprimtaria kriminale, për të cilën ka filluar dhe procedimi penal ndaj të dyshuarit D.L., të trafikimit të lëndëve narkotike, ka ndodhur në periudhën xxx, kur është arrestuar në xxx dhe shtetasi K.K. dhe **se për shkak të pamjaftueshmërisë së provave, se fajësia e tij për këtë veprë penale nuk provohet tej cdo dyshimi të arsyeshem.** ai nuk është gjendur fajtor per kryerjen e vepres penale të "Trafikimit të narkotikeve" në bashkepunim sipas nenit 283/a -2 të Kodit Penal por në referim të nenit 4 e 375 të K.Pr.Penale, ai është deklaruar fajtor e dënuar për veprën penale të "Moskallëzimit të krimit" sipas nenit 300/1 te K.Penal, i lënë në fuqi nga **Gjykata e Apelit për Krime të Rënda**

06. Në çmim të kësaj Gjykate, Vendimet e sipercituara të Gjykatës, e në veçanti arsyetimi se "ndaj të dyshuarit D.L., për shkak të pamjaftueshmërisë së provave, **fajësia e tij për këtë veprë penale të "Trafikimit të narkotikeve"** në bashkepunim sipas nenit 283/a -2 të Kodit

Penal) **nuk provohet tej cdo dyshimi të arsyeshëm**, kjo gjykatë vlerëson se përbushen kriteret e nenit 24 pika 2 germa “c” e ligjit sipas të cilit:

“ Gjykata mund të vendosë pranimin e kërkesës për konfiskimin e pasurisë edhe kur:

c)” *personi është proceduar për një vepër penale, që përfshihet në fushën e zbatimit të këtij ligji, por gjatë procedimit penal ndryshohet cilësimi juridik i veprës dhe vepra e re është jashtë fushës së zbatimit të këtij ligji. ”*

Në këto rrethana Gjykata, konkludon se i gjykuari D.L. mbetet subjekt i ligjit 10192 datë 03.12.2009 dhe ndaj të cilit ekziston një “*dyshim i arsyeshëm të bazuar në indicie*”, të parashikuar në nenin 3 prg 1 të ligjit parandalues, pasi vepra penale për të cilën ka filluar procedimi penal, përfshihet në rrethin e atyre të parashikuara nga neni 3 prg i parë germa “ç” i ligjit të posaçëm.

07. Nga hetimi pasuror i kryer rreth të paditurit D.L., familjarëve të tij, si persona të lidhur me të (sipas nenit 3 prg 2-a të ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009), janë paraqitur aktet nga prokuroria për Krime të Rënda Tiranë në mbështetje të kërkesës.

08.1 Sic rezulton nga hetimi pasuror, mbi bazën e kërkesës së Prokurorisë për Krime të Rënda, me vendimin nr xx date xxx kjo Gjykate ka vendosur ndër të tjera:

“ Sekuestrimin e pasurisë prane Bankes xxx dhe me konkretisht : Llogaria me nr. xxx ne shumen xxx leke.

Llogaria me nr. xxx ne shumen xxx USD Llogaria me nr. xxx

ne shumen xxx euro Llogaria me nr. xxx ne shumen xxx euro.

Shuma prej xxx euro dhe xxx lekesh.

Per ekzekutimin e ketij vendimi ngarkohet Zyra e Permbarimit Gjyqesor, xxx.

Per Administrimin e kesaj pasurie te ngarkohet z. K.Xh., i cili eshte administrator prane Agjensise per Administrimin e pasurive te Sekuestruara dhe te Konfiskuara prane Ministrise se Financave Tirane..... ”

Ky vendim, i cili ka marre forme te prere nepermjet vendimit nr.xx date xxx të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë, është ekzekutuar duke u zbatuar tërësisht ky vendim, më datë xxx.

08.2 Në vijim të afatit, gjatë të cilit kryhej hetimi pasuror ndaj shtetasit D.L., me date xxx nga Prokuroria per Krime te Renda eshte paraqitur kerkese për zgjatje te afatit te sekuestros se vendosur me vendimin Nr xx datë xxx të Gjykeses se Shkallës së Parë për Krime Të Rënda Tiranë, dhe me vendimin nr xx date xxx te saj është vendosur pranimi i kerkeses *duke u zgjatur ky afat i sekuestros edhe tre muaj, nga data xxx.*

08.3 Ndërkaq pas ankimit të kërkuarit, Gjykata e Apelit me vendimin Nr xx datë xxx, është shprehur se në kushtet kur provohet se kërkesa per zgjatje te afatit nuk është bërë brenda afatit ligjor, *vendimi i gjykeses se faktit duhet ndryshuar dhe kerkesa duhet rrëzuar si e paraqitur jashte afatit ligjor duke vendosur:*

”Ndryshimin e vendimit nr xx datë xxx te Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë si më poshtë: Rrëzimin e kërkesës së paraqitur nga Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë.”

08.4. I padituri D.L. ka kërkuar **shuarjen e sekuestros së vënë me vendimin nr xx datë xxx të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë dhe me vendimin e ndermjetëm të datës xxx pasi dëgjoi dhe prokurorin, kjo gjykatë, , në referim te vendimit nr xx**

datë xxx të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë, vendosi ‘Konstatimin e shuarjes se masës së sekuestrimit të pasurisë të kërkuesit D.L. dhënë me vendimin nr xx datë xxx të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë’.

08.5 Ndërkohë pavarësisht këtij fakti, bazuar ne nenin 21 paragrafi i dytë të Ligjit 10192 se *‘konfiskimi i pasurisë kërkohet dhe vendoset edhe ne raste kur ndaj pasurive nuk është kërkuar dhe vendosur masa e sekuestrimit’* ndaj dhe prokurori ka vijuar me kërkesën për konfiskim të paraqitur më datë xxx.

09. Të dhënat dhe provat e paraqitura nga ana e organit të prokurorisë (që ka barrën e provës në gjykimin parandalues/preventiv, për të vërtetuar se personi nën hetim përmbush kushtet dhe kriteret ligjore për t’u cilësuar si *‘personi i dyshuar’*, ndaj të cilit mund të zbatohen masat parandaluese, sipas ligjit parandalues), në vlerësimin e kësaj Gjykate, justifikojnë ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm jo vetëm për përfshirjen e shtetasit D.L. në aktivitet kriminal, por edhe për krijimin e një pjesë të pasurisë si rezultat i kësaj veprimtarie.

10. Vepra penale për të cilën fillimisht është dyshuar shtetasi D.L. nga natyra e saj është fitimprurëse për autorët dhe se nga gjykimi penal, të gjykuarit e kanë kryer atë pikërisht për të përfituar të ardhura te konsiderueshme që realizohen nga ky aktivitet i paligjshëm, ndërkohë sic u citua më lart me vendimin e Gjykatës Nr 15 datë 01.02.2013, pala e paditur/i pandehuri D.L. është deklaruar fajtor për veprën penale te *‘Moskallëzimit të krimit’*.

11. Aktualisht ka rezultuar se në emër të të paditurit D.L., disponohen pasuritë e mëposhtme: ***Pasurisë pranë Bankës xxx dhe me konkretisht :***

Llogaria me nr. xxx ne shumen xxx leke. Llogaria me nr. xxx ne shumen xxx USD Llogaria me nr. xxx ne shumen xxx euro Llogaria me nr. xxx ne shumen xxx euro.

Të shumës prej xxx euro dhe xxx lekesh.

10. Gjithashtu, nga hetimi pasuror është vërtetuar se pasuritë e mësipërme janë krijuar/celur nga i hetuari D.L. si vijon:

a. Llogaria me nr. xxx pranë Bankës xxx, është hapur në datë xxx dhe deri ne ditën e sekuestrimit ne te jane disponuar shuma **xxx leke;**

b.Llogaria me nr. xxx pranë Bankës xxx, është hapur në datë xxx dhe deri ne momentin e sekuestrimit jane ndodhur ne te shuma **xxx USD;** c.Llogaria me nr. xxx pranë Bankës xxx, është hapur në datë xxx dhe u provua se në **datën xxx**, i dyshuari D. ka depozituar shumen **xxx euro;**

d.Edhe Llogaria me nr. xxx e hapur pranë Bankës xxx, në datë xxx dhe u provua se ne të njëjtën datë **xxx**, është e depozituar shuma **xxx euro.**

Pra në gjykim u provua se dy shumet e fundit secila prej nga xxx Euro secila, gjithësej xxx euro janë të depozituara nga i dyshuari, në të njëjtën datë xxx.

e. Ndërsa në momentin e arrestimit më datë xxx në banesë i janë sekuestruar edhe një shumë prej xxx USD, xxx euro dhe xxx lekesh .

Rezulton se Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr xx date xxx ka vendosur kthimin të dyshuarit D.L. shumen prej xxx euro, xxx dollarë amerikane si dhe shumën prej xxx lekë,. Ky vendim ka marre forme te prere me date xxx.

Prandaj nga vlerat monetare të sekuestruara në banesë më datë xxx, mbeten objekt i

kësaj kërkesë për konfiskim vetëm shumat si vijon:

- Të shumës prej xxx euro dhe xxx lekesh që aktualisht rezultojnë pranë Bankes xxx e xxx Bank.

Në tërësi Gjykata konstaton se shumat monetare të sipërcituara, të sekuestruara të dyshuarit D.L., janë krijuar në kohë në të cilën, siç u argumentua më lart, është provuar se ka qënë i përfshire në aktivitetin kriminal të “Trafikimit të lëndëve narkotike”, i dyshuari D.L.

11. Me qëllim verifikimin e të ardhurave të familjarëve e të shtetasit D.L. nga prokuroria janë kryer edhe verifikime për vlerat monetare të depozituara në bankat e ndryshme të nivelit të dytë si dhe disponimit prej tij apo të familjarëve të pasurive të paluajtshme apo mjete motorike që kanë disponuar deri në ditën e arrestimit të shtetasit D.L. datë xxx.

12.1 Me aktet që janë paraqitur si fashikull gjykimi e pales paditese, janë përvescë aktet e depozituara gjatë hetimit të kërkesës nga pala e paditur, edhe aktet e prokurorisë sikundër -Shkresë nr xx date xxx e Prokurorisë Per Krime te Renda Tirane, drejtuar Bankes xxx(Dega xxx(xxx) si dhe Bankes xxx-xxx(xxx);

-Vendim per “Sekuestrimin e llogarive bankare” date xxx te prokuroreve E.N. dhe Y.B.

- Procesverbal per “Sekuestrimin e llogarive Bankare” date xxx.

- Procesverbal per sekuestrimin e provave materiale, date xxx, sende te sekuestruara personit nen hetim D.L.

-Shkresa kthim pergjigje e xxx–Dega xxx (xxx) date xxx dhe bashkengjitur saj dhe listen e printuar te llogarive te shtetasit D.L.

-Mandat arketimi mbi dorezimin e vlerave monetare te sekuestruara, date xxx prane xxx Bank te shumave xxx Euro, xxx USD si dhe xxx leke shoqeruar me mandat arketimet perkatese.

-Vendim nr.xx, date xxx i Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane.

-Urdher per regjistrimin e procedimit penal date xxx.

-Urdher per regjistrimin e emrit te personit qe i atribuohet vepra penale, per procedimin penal nr xx/xxx, date xxx.

- Kerkese per gjykim, per procedimin penal nr xx te vitit xxx per te pandehurit D.L.; O.T.; A.C. date xxx.

-Vendim “Per kalimin e akteve seksionit per hetimet pasurore” date xxx;

– Shkresë me nr.prot xxx/x.E.D i dates xxx derguara Z.Q.R.P.P-se bashkangjitur se ciles ndodhen pergjigjet perkatese te Z.R.P.P mbi banesën që disponohet nga i ati i të hetuarit, shtetasi V.L.

– Shkresë me nr.prot xxx/x.E.D i dates xxx derguar Qendres Kombetare te Regjistrimit.

– Pergjigje me shkresë nr.prot xxx i dates xxx

– Shkresë me nr.prot xxx/x E.D i dates xxx derguar Qendres Kombetare te Licensimit.

– Pergjigje me shkresë nr.prot xxx/x i dates xxx.

– Shkresë me nr.prot xxx E.D i dates xxx derguar Drejtorise se Pergjithshme te Parandalimit te Pastrimit te Parave Tirane.

– Pergjigje me shkresë nr.prot xxx/xx i dates xxx

- Pergjigje me shkresë nr.prot xxx/x i dates xxx
- Shkresë e dates me nr.prot xxx/x E.D date xxx derguar Drejtorise se Pergjithshme te Sherbimit te Transportit Rrugor Tirane mbi mjetet e te hetuarit D.L., G.N. e V.L.
- Pergjigje me shkresë nr.prot xxx/x i dates xxx.
- Shkresë me nr.prot xxx/x E.D i dates xxx derguar “Aluizni-t” Tirane.
- Pergjigje me shkresë nr.prot xxx/x i dates xxx
- Shkresë me nr.prot xxx/x E.D i dates xxx derguar Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve Tirane.
- Pergjigje e Drejtorise Rajonale xxx me shkresë nr.prot xxx i dates xxx;
- Pergjigje e Drejtorise Rajonale xxx me shkresë nr.prot xxx/x i dates xxx;
- Pergjigje e Drejtorise Rajonale xxx me shkresë nr.prot xxx/x i dates xxx;
- Shkresë me nr.prot xxx/x E.D i dates xxx derguar Drejtorise se Pergjithshme te Doganave xxx;
- Pergjigje me shkresë nr.prot xxx/x i dates xxx;
- Shkresë me nr prot xxx-xxx E.D i dates xxx derguar Bankave te Nivelit te Dyte qe operojne ne territorin e Republikes se Shqiperise, bashkengjitur se ciles ndodhen pergjigjet perkatese te ketyre bankave mbi veprimet financiare te te hetuarit dhe me cilësinë e administratorit te ‘xxx’.
- Vendim nr.xx i dates xxx i Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te renda Tirane per sekuestrimin e pasurise se shtetasit D.L.
- Vendim nr. xx i dates xxx i Gjykates se Apelit per Krime te Renda Tirane per sekuestrimin e pasurise se shtetasit D.L.
- Vendim nr.xx date xxx i Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane mbi kerkesen per shuarjen e afatit te sekuestrimit te pasurise se shtetasit D.L.
- Vendim nr.x date xxx i Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane mbi zgjatjen e afatit te sekuestrimit te pasurise se shtetasit D.L.
- Vendim nr.xx date xxx i Gjykates se Apelit per Krime te Renda Tirane mbi kërkesën për shuarjen e sekuestrimit te pasurise se shtetasit D.L.
- Vendim nr xx datë xxx i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.
- Si dhe materialet e dorëzuara nga avokati mbrojtës me kerkesat e datave: xxx(shkresa nr xxx dhe xxx datë xxx e Bashkisë xxx; vërtetim nr xx/xx x datë xxx i sigurimeve shoqërore që provon se për periudhën nga xxx deri në xxx xxxka punuar si përmbarues gjyqësor ne xxx me pagë mujore xxx leke; ekstrakt i QKR për bashkëshorten e të paditurit G.N. e cila është regjistruar si notere me datë xxx; Vërtetimet e xhiros nga Bashkia xxx që mban nr xxx datë xxx për G.N. për vitet xxx-xxx sipas së cilave ajo ka deklaruar xhiro gjithsej xxx Lekë ; Vërtetim Nr xxx Prot datë xxx i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, sipas të cilit të ardhurat e G.N. si notere për vitet xxx-xxx ka qenë gjithsej xxx lekë”, Pasqyrë e fitimit të ‘xxx’ për vitet xxx-xxx, sipas së cilës pasqyrohet se pjesa e fitimit të D.L. është xxx Lekë; pasqyrë e bilanceve të xxx për vitet xxx-xxx; Vërtetim page i periudhës xxx xxx-xxx xxx si përmbarues në xxx me pagë mujore xxx të akteve dorëzuar më datë xxx ku nëpërmjet një shkresë Nr xxx datë xxx e xxx Bank si dhe kontrate e të paditurit me banken datë xxx bashkë me të dhënat për pagesat e shërbimeve si avokat i Bankës dhe shumat sipas të cilave ai është paguar në shumën xxx Euro dhe xxx lekë i tatuar dhe në burim; të akteve të dorëzuara nga mbrojtësi gjatë periudhës së hetimit pasuror nga prokurori më datë xxx dhe dorëzimit të

akteve me shkresën datë xxx mbi shkresat e Spitalit xxx ku vërtetohen pagat e marra nga prindët e të hetuarit D. e V.L., vërtetimet e pagave të tyre si dhe Vërtetim nr xxx Prot datë xxx i bashkisë xxx sipas së cilës shtetasit D. e V.L. (prindët e të hetuarit D.) nga xxx deri ne xxx kanë ushtruar aktivitet privat me vlerën e deklaruar prej xxx lekë, Vërtetim të ardhurash nga puna si mjekë pranë Klinikës mjekësore ortodokse xxx me të ardhura të përgjithshme prej xxx, shoqeruar nga praktikat perkatese.

– Shkrese me nr.prot xxx e dates xxx e derguar nga Agjensia e Administrimit te Pasurive te Sekuestruara dhe te Konfiskuara shoqeruar nga praktika perkatese se bashku me procesverbalet e marrjes ne administrim.

– Procesverbal per sekuestrimin e provave materiale, date 31.05.2012, sende te sekuestruara personit nen hetim Devis Lushnjari.

– Vendim per “Sekuestrimin e llogarive bankare” date xxx te prokuroreve E.N. dhe Y.B.

– Procesverbal per “Sekuestrimin e llogarive Bankare” date xxx.

– Formular i bankes xxx, date xxx, ku jane depozituar shumat e sekuestruara

– Fature per arketimin e shumes date xxx.

– Faturat per derdhjen e shumes ne llogarine e Prokurorise se Pergjithshme per shumat ne vlerën xxx Euro dhe xxx lekë.

– Urdheri per regjistrimin e procedimit pasuror më datë xxx.

– Vendim “Per kalimin e akteve seksionit per hetimet pasurore” date xxx.

12.2 Gjithashtu nga i padituri, përvec akteve të depozituara gjatë hetimit ndodhur ne fashikull, periudhës deri në datën e paraqitjes se kërkesës për konfiskim prej paditesit, Prokurorisë për Krime te Rënda, ka paraqitur dhe gjatë gjykimit aktet:

-Terheqjet per periudhën xxx xxx-xxx xxx, nga i hetuari i procedimit pasuror D.L., nga llogarite e: Bankes xxx; “Bankes xxx”; Bankes ‘xxx; Bankes xxx(xxx); Bankes ‘xxx’; Bankes xxx; Bankes xxx; Banka e xxx; nga ‘xxx Bank’.

-Vertetim page, për D.L. per periudhen xxx xxx - xxx xxx nga xxx;

-vendimi nr.x date xxx te Gjykates Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane;

-vendimi nr.xx date xxx Gjykates Apelit per Krime te Renda Tirane

-Vertetim i pages si administrator i shoqerise ‘xxx’

-Vertetim i bankes xxx i llogarisë nr xxx qe ajo llogari eshte ajo ne te cilen eshte derdhur paga nga ‘xxx’xxx që sipas të paditurit në cilësine e administratorit dhe ortakut të kësaj shoqërie ka kryer veprime te terheqjes se shumave që janë pjesë e fitimit të Shoqërisë, të disponuara nga ortakët për interesat e tyre.

Gjithashtu janë pranuar gjatë gjykimit si akte të domosdoshme për kryerjen e ekspertimit kontabël kërkuar dhe nga eksperti në seancë gjyqësore, të paraqitura nga i padituri D.L. sikundër :

- Vërtetimet e Shlyrjes se detyrimeve te taksave vendore per vitin xxx dhe sigurimeve shoqerore; per vitet xxx,xxx,xxx,xxx te D.L. e G.N.

- Shlyrje e detyrimeve te taksave vendore dhe sigurimeve shoqerore xxx-xxx.

- Deklarim dhe pagese e kontributeve te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore xxx-xxx xxx; Sigurimet shoqerore xxx-xxx xxx

- Derdhja e Sigurimeve shoqerore shendetesore xxx –xxx xxx; Skema e

kontributeve te sigurimeve Shendetesore xxx-xxx-xxx;

- Shlyerja e "Taksat vendore" per vitet xxx-xxx-xxx
- Fatura, mandat pagese e mandat arketime.
- Si dhe kontratat e qerase e shtetases G.N. per ambientet e ushtrimit të detyrës si "Notere" ne xxx nga viti xxx- deri xxx.
- Vendimi nr.x date xxx i Asamblesë së jashtëzakonshme të ortakëve të shoqërisë "xxx" si dhe
- Vendimin nr x datë x për miratim pasqyrash financiare te vitit ushtrimor x dhe për "Miratim Destinim Fitimi" i xxx".

12.3 Nga ana e Gjykatës, në kushtet kur janë konstatuar mospërputhje mes të dhënave pasqyruar në shkresat "Vërttim Nr xxx Prot datë xxx; Shkresë kthim - përgjigje nr xxx Prot datë xxx dërguar Prokurorisë për Krime të Rënda Tiranë si dhe nga ana e

Drejtorisë se Tatim-Taksave, Bashkia xxx është kthyer **përgjigje nr xxx prot date xxx**, me te dhëna mbi aktivitetin e personit fizik, **G.N.** me objekt aktiviteti "**xxx**" janë kërkuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore xxx të dhëna të plota e të sakta si dhe një kopje e minibilanceve në lidhje me këtë subjekt për kryerjen e aktit të ekspertimit kontabël.

Aktet e ardhura nepermjet shkreses nr.xxx prot date xxx nga Ministria e Financave, Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve, Drejtoria Rajonale Tatimore xxx,depozituar ne gjykate me date xxx, se bashku me pasqyrat financiare te subjektit G.N., bazuar ne nenin 12 dhe 213 te K.Pr.Civile, kjo gjykate i bëri pjesë të fashikullit të gjykimit.

12.4. Provë e marrë gjatë gjykimit qe dhe kryerja e aktit të ekspertimit kontabël nga eksperti kontabel i miratuar me konkluzionet dhëne përfundimisht pas aktit shtesë në datë xxx është paraqitur si përfundimtar akti me konkluzionet në këtë datë, që iu nënshtrua debatit gjyqësor e më pas duke u konsideruar dhe një pjesë e konkluzionit të tij.

13. Kjo Gjykatë cmon e vlerëson se, nga aktet e provat e marra në këtë gjykim, *bindet plotësisht se pasuritë e luajtshme(llogaritë bankarë) që kërkohen të konfiskohen janë në emër të shtetasit të hetuar D.L. (datat janë cituar më lart), shuma monetare të cilat kërkohen të konfiskohen, që fillimisht janë sekuestruar me vendimin nr.xx, datë xxx, të Gjykatës për Krime të Rënda, Tiranë, vendim i cili është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin nr xx, datë xxx dhe që pavarësisht faktit se është konstatuar "shuarja e sekuestros"* kërkesa për konfiskim të tyre ka vijuar konform nenit 21 të Ligjit të posacëm 10192.

14. Pra, Prokuroria për Krime të Rënda, pasi ka vijuar mbledhjen e provave në lidhje me pasuritë e luajtshme që i ishin sekuestruar shtetasit D.L., ka depozituar në gjykatën e shkallës së parë kërkesën (padinë) për konfiskimin e tyre.

Në bazë të kërkesës së palës së paditur e pranuar dhe nga pala paditëse, nga ana e Gjykatës u vendos te kryhej akti i Ekspertimit-Kontabël, sipas detyrave pasqyruar në atë vendim të datës xxx, për të përcaktuar të ardhurat e siguruara nga I padituri D.L. prej punes se tij nga viti xxx deri ne daten e arrestimit te tij xxx; të shtetases G.N., bashkëshortes së paditurit D.L. nga data e martesës se tyre (datë xxx sipas certifikatës së martesës e certifikatës familjare datë xxx) deri ne daten e arrestimit të të hetuarit/paditurit D.L.; shpenzimet e secilit për shkak të aktiviteteve të tyre si dhe përlllogaritjen e fitimit neto, shpenzimet për blerjen e

autoveturave prej tyre, mirembajtjen e kryerjen e sherbimeve dhe karburantin e shpenzuar si dhe shpenzimet per jetese te te paditurit, bashkeshortes e djalit si dhe duke konkluduar mbi bilancin perfundimtar të të ardhurave e shpenzimeve si me siper duke percaktuar fitimin neto per cdo vit, për secilin, te paditurit D.L. e G.K.N.

15. Pasi ia ka nënshtuar debatit gjyqësor provat e paraqitura nga palët ndërgjyqëse, si dhe pas realizimit të nje akt **ekspertimi kontabël financiar**, kjo gjykatë konform nenit 303 të K.Pr. Civile i ftoi palët në konkluzionet/bisedimet përfundimtare.

15.1. a. Përfaqësuesi i palës paditëse në gjykim, prokurorisë për krime të rënda, në diskutimin e tij përfundimtar kërkoi konfiskimin e te gjitha vlerave monetare që dhe kishte kërkuar të konfiskoheshin duke dhënë dhe pretendimin e argumentin përkatës që në tërësi të përmbajtjes së bisedimeve duhet te pranohej kerkesa pasi:

Plotesohen kerkesat e nenit 24/1 te Ligjit 10192 datë 03.12.2009, për konfiskimin e pasurisë, pasi ka dyshime të arsyeshme për pjesmarrje ne aktivitet kriminal, nuk provohet prejardhja e ligjshme e tyre dhe pasuria është në disponim të plotë të personit, duke argumentuar se nuk janë të justifikuara ligjërisht pasurite e luajtshme te shtetasit D.L., shumat monetare te sekuestruara dhe se ka dyshime se rrjedhin nga burime kriminale. Gjithashtu dhe fakti se shumat monetare prej xxx euro + xxx euro janë depozituar ne muajin xx xxx, ne menyre te menjehershme dhe nuk jane depozita shuma e te cilave është rritur në mënyrë graduale apo me shtrirje kohore.

15.1. b. Nga përfaqëuesi i palës paditëse gjithashtu u pranua fakti se janë të dhëna të sakta e te pranueshme për shumën e të paditurit në masën prej xxx lek e siguruar nga te ardhurat ne kohen xxx-xxx prej punes si përmbarues gjyqësor shtetëror ne xxx.

15.1c Se aktet e paraqitura për sherbimet juridike për xxx nuk pasqyrojne sherbimet juridike të kryera per të si dhe vleresohen pa fuqi provuese edhe te ardhurat e pretenduara si te realizuara nga i padituri per aktivitetin si avokat per vitet xxx-xxx pasi nuk u sollen dokumente konkrete per te provuar te ardhurat, por pasqyrohen vetem rubrika “xhiro te realizuar dhe jo fitim apo te ardhura neto”.

15.1d Nje argument tjetër i prokurorit u ngrit ne lidhje me te ardhurat e pretenduara prej te paditurit, te realizuara nga shoqëria xxx, kur provohen vetem shperndarja e dividendit te vitit xxx për te cilin Asambleja e ortakeve ka vendour të shperndaje fitimin e me vendimin nr x datë xxx ne shumen xxx lekë, ndërsa fitimi i pretenduar nga shoqëria i vitit xxx, që prej të paditurit deklarohet se e ka marrë para dates kur janë depozituar vlera e shumave, objekt konfiskimi, nuk është real dhe i vërtetë pasi Asmbleja e Ortakëve ka marrë vendimin nr x me datë xxx dhe pagesa mbi dividendin është bërë më datë xxx e nderkaq prokurori e cmon të pambeshtetur pretendimin e të paditurit L. se si ortak i shoqerisë mund ta tërhiqte fitimin ne raportin prej 33% ne cdo moment, por nuk u soll ndonjë akt/vendim marrje e Asamblesë së Ortakëve që të provohej se keshtu kishte ndodhur.

15.1e Mbi fitimet e shtetases G.N., megjithese u pretenduan fitime te mëdha, rezultuan në total, pas administrimit te akteve e shkresave) se fitimi i realizuar nga kjo shtetase per periudhën xxx-xxx ishte në vlerën xxx, si dhe mbi totalin e shpenzimeve per jetese te te paditurit e familjes, gjatë të njëjtës periudhe, u përlllogarit xxx, që prokurori u shpreh se nuk është reale dhe se ne kushtet kur fitimi i realizuar nga familja e të paditurit është në kufijtë e barazisë me shpenzimet e realizuara duke mos justifikuar burimin e ligjshem te shumave

monetare te sekuestruara me vendimin nr xx datë xxx.

15.2. Pala e paditur D.L. e mbrojtësi L. duke i qëndruar prapësimeve të paraqitura shprehen se pretendimet e pales paditëse nuk qëndrojnë pasi duke u mbështetur në aktin e ekspertimit kontabël te datë xxx pasqyrohet se te ardhurat neto të familjes së të paditurit D.L. janë në total xxx lekë, të realizuara në rruge e mënyrë të ligjshme dhe jane paguar detyrimet financiare sipas legjislacionit tatimor.

15.2.a. Se të ardhurat e ligjshme të D.L. në masën prej xxx kur ka punuar si përmbarues Gjyqësor shtetëror, janë pranuar dhe nga prokurori. Se nga sherbimet juridike per xxx Bank si dhe terheqjet e kryera nga i padituri në tërësi arrijnë xxx lekë provuar nga ekstraktet bankare të paraqitura dhe fitimi përlllogaritet në vlerën xxx lekë.

15.2.b Se të ardhurat e krijuara si Ortak dhe administrator i Shoqërisë xxx duke u pranuar dhe nga pala paditëse janë në vlerën prej xxx lekë dhe ndërkohë paga e tij i është derdhur në një nga llogaritë me vlera te sekuestruara ne shumën xxx lekë.

15.2.c Duhet të pranohet konkluzioni i ekspertit se mbi fitimin e krijuar si dividend për vitin xxx nga ‘xxx’ në msën takuese prej 33% vlera takuese ka qenë xxx, duke pretenduar se jane paraqitur mandat arkëtimet e mandat pagesat nga arka e shoqërisë .

17.2.d. Se është pranuar dhe fitimi i realizuar nga bashkëshortja G.N. e te paditurit D.L. e në tërësi nga mbrojtësi e i padituri u pretendua se depozitat qe mbajnë shumat prej xxx euro secila janë celur jo në muajin prill të xxx por qershor e shtator xxx.

15.2.e Përfundimisht nga i padituri e mbrojtësi u shprehen se pasuritë objekt gjykimi për të cilat është paraqitur kërkesë për konfiskim jane krejtësisht të justifikuara dhe te krijuara ne mënyrë të ligjshme, e duke i kërkuar përfundimisht Gjykatës duke kërkuar të rrëzojë padinë si dhe të shprehet mbi pasojat për dëmin e shkaktuar (interesin) nga bllokimi i ketyre shumave si dhe revokimin e sekuestros ne referim te ligjit 10192 datë 03.12.2009.

16. Gjykata për Krime të Rënda, në përfundim të hetimit gjyqësor, vlerëson se padia duhet pranuar pjesërisht, për dy nga llogaritë bankare pranë ‘xxx Bank’ atë me numër xxx me shumen xxx euro dhe me nr. xxx me shumen xxx euro duke **vendosur konfiskimin e kalimin në favor të shtetit të shumës në total prej xxx (xxx) Euro**, në kushtet kur nga pala e paditur nuk u arrit të provohej ligjshmëria e krijimit të këtyre shumave monetare, të cilat janë depozituar brenda së njëjtës ditë e në mënyrë të menjëhershme.

17. Ndërsa mbi vlerat monetare në llogaritë pranë xxx Bank me nr. xxx me shumen xxx leke që është dhe llogaria e derdhjes së pagës si administrator i shoqërisë ‘xxx’; e te vlerave monetare ne llogarinë me nr. xxx ne Shumen xxx USD; apo të shumave të sekuestruara në banesë prej xxx euro dhe xxx lekesh (të ndodhura aktualisht pranë xxx Bank e xxx Bank), Gjykata vlerëson se këto shuma, sipas hetimit gjyqësor të zhvilluara, provave të paraqitura dhe ekspertimit kontabël të kryer nga eksperti Gj.H., janë të justifikueshme.

Në këtë përfundim vjen gjykata pasi vlerësoi se të ardhurat e fitimet nga puna e të paditurit D.L. si, përmbarues gjyqësor si dhe nga të ardhurat e fitimet e krijuara nga bashkëshortja e tij G.N. nga aktiviteti i saj në profesionin e lirë si ‘Notere’, kanë qënë të atij niveli që e justifikon shumat e depozituara në llogaritë xxx; xxx si dhe ato të gjenduara në banesë në datën xxx. Prandaj vendimi i gjykatës Nr xx datë xxx sipas të cilit janë sekuestruar këto shuma duhet të revokohet.

Vlerësimi i Gjykatës për pretendimet e palëve dhe qëndrimi i saj përfundimtar për objektin e kërkesës për gjykim.

18. Në përfundim të gjykimit, kjo Gjykatë, në analizë të pretendimeve të parashtruara nga paditësi e pala e paditur, të provave të analizuara e verifikuara në gjykim, të ballafaquara me dispozitat ligjore përkatëse, arrin në përfundimin se kërkesa/padia duhet pranuar pjesërisht duke u shprehur si më poshte.

20. Gjykata vlerëson që në marrjen e vendimit analizon kërkesat e nenit 24, pika 1 të ligjit parandalues, i cili parashikon:

“1. Gjykata vendos konfiskimin e pasurive kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) kur ka dyshime të arsyeshme, bazuar në indicie, për pjesëmarrjen e personit në veprimtari kriminale të parashikuara në nenin 3 të këtij ligji;

b) kur nuk provohet se pasuria ka prejardhje të ligjshme, apo personi nuk justifikon zotërimin e pasurive ose të të ardhurave, që nuk i përgjigjen dukshëm nivelit të të ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të ligjshme, të deklaruara dhe as nuk justifikohen prej tyre; dhe

c) kur rezulton se pasuria është drejtpërdrejt ose tërthorazi në zotërim të pjesshëm apo të plotë personit.”

2. Gjykata mund të vendosë pranimin e kërkesës për konfiskimin e pasurisë edhe kur :

.....

c) personi është proceduar për një vepër penale , që përfshihet në fushën e zbatimit të këtij ligji, por gjatë procedimit penal ndryshohet cilesimi juridik i veprës dhe vepra e re është jashtë fushës së zbatimit të këtij ligji.”

Në interpretim të këtij neni, gjykata çmon se kur vendoset masa e konfiskimit mbi një pasuri të konsideruar si e paligjshme, duhet që të provohet ekzistenca e prania e kushteve të përcaktuara nga kjo dispozitë.

Gjykata konstaton se, si gjatë gjykimit edhe në konkluzionet përfundimtare, Prokuroria për Krime të Rënda, analizoi dhe argumentoi shkakun për palën e paditur të këtij procesi gjyqësor, mbi ekzistencën e kushtit të parashikuar në pikën “a” të nenit 24 të ligjit të sipërcituar; duke evidentuar palen e paditur, arsyen dhe pasuritë e të cilës kërkon që të konfiskohen, për të dyshuarin D.L., në raport me veprimtarinë e tij kriminale.

Pra në ndryshim nga detyrimi dhe “barra e provës” për provuar se personat fizike e juridikë, të cilëve kërkon tju konfiskojë pasurinë, janë subjekte të ligjit parandalues, në konkluzionet përfundimtare Prokuroria për Krime të Rënda, evidentoi konstatimin ndër të tjera se :

“....janë subjekte të hetimit pasuror sipas ligjit nr.10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, sipas nenit 3/1 pika « ç », pasi është hetuar e gjykuar nga autoritetet shqiptare, duke u hetuar për veprën penale të “Trafikimit të lëndëve narkotike”, parashikuar si e tillë në nenin 283/a të Kodit Penal Shqiptar, , si dhe provat e paraqitura nga i padituri nuk justifikojnë tërësisht pasuritë e krijuara prej tij.

Për pasojë edhe personat e lidhur me të, janë subjekte të zbatimit të këtij ligji sipas

nenit 3/2.”

Ky qëndrim i Prokurorisë vlerësohet nga Gjykata, në kuadër të frymës së ligjit parandalues dhe interpretimit që i ka bërë atij **Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në Vendimin Nr 04 datë 23.02.2011**, për detyrimin e vërtetimit të dyshimit të arsyeshëm, bazuar në indicje, për pjesëmarrjen e personit në veprimtarinë kriminale të parashikuar në nenin 3 të ligji 10 192 datë 03.12.2009 ”Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Ndër të tjera në këtë vendim, Gjykata Kushtetuese, ka përcaktuar detyrimet e secilës prej palëve gjatë gjykimit të çështjeve me objekt sekuestrimin e konfiskimit e pasurive sipas ligjit të sipërcituar si vijon:

“ Gjykata, në ligjin objekt shqyrtimi vlerëson se, barra e provës fillimisht i takon prokurorit për të argumentuar dyshimin e arsyeshem bazuar në indicje, se një person është pjesëmarrës në krimin e organizuar dhe trafikim sipas veprave të parashikuara në nenin 3 të Ligjit.

Mbështetur në verifikimet e kryera, prokurori ka detyrimin për të parashtruar kërkime të motivuara dhe të dhëna mbështetëse përpara gjykatës për identifikimin e pasurive të personit të dyshuar dhe të personave të tjerë; të tregojë nga ana e tij se ka baza për dyshim të arsyeshëm dhe të dhëna të mjaftueshme për efekt të gjykimit parandalues, se ato nuk janë pasuri të fituara në rrugë të ligjshme, çka motivon ekzistencën e prezumimit të paligjshmërisë së tyre, dhe si rezultat, kalimin e barrës së provës personit të dyshuar.

Pas kësaj, barra e provës kalon te personi i dyshuar, për të justifikuar origjinën e ligjshme të pasurive të tij, për të argumentuar mungesën e lidhjes së pasurisë me cilësimin si produkte të veprave penale ose investim të tyre.

Më pas është detyrë e gjykatës që të sigurojë zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, të kryejë një hetim të gjithanshëm dhe të plotë, për dhënien e një vendimi të drejtë dhe të mbështetur në ligj.

Pra, në dallim nga procedimi penal, gjykimi parandalues mbështetet në dyshimin e arsyeshëm bazuar në indicje, duke iu ngarkuar barra e provës personit të dyshuar dhe personave të tjerë, për të vërtetuar ligjshmërinë, për justifikimin e origjinës së pasurisë. Pra, në këtë proces, barra e provës është e ndarë ndërmjet prokurorit dhe personit të cilit do t'i sekuestrohet ose konfiskohet pasuria.

Në këtë këndvështrim, **Gjykata duhet të vlerësojë kërkesën për konfiskim** të paraqitur nga Prokuroria për Krime të Rënda, sipas ballafaqimit të rrethanave të faktit e provave të paraqitura nga palët në këtë gjykim, konform përcaktimit të nenit 24 të ligjit 10 192 datë 03.12.2009 ”Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Subjekti i këtij procedimi pasuror, Gjykata, vlerëson se ka rolin e specifikën e tij si për pjesëmarrjen **në veprimtarinë e dyshuar si kriminale**, (veprimtari e cila, nuk mund të jetë çfarëdo, por vetëm nga ato veprimtari kriminale që përcaktohen në nenin 3 të ligjit parandalues), ashtu edhe përfshirjen në krijimin e llogarive të tij objekt konfiskimi, në këndvështrim e në bazë të nenit 24 të ligjit 10.192 datë 03.12.2009 të Ligjit.

Sipas ligjit parandalues, jo vetëm në nenin 24/1 pika ‘b’ e ‘c’ e tij, por edhe në disa dispozita të tjera të shpërndarë në këtë ligj (si psh në nenet 2,6, 11/1, 21/2 e 3 të këtij ligji) , ligjvënësi ka përcaktuar se subjektet, mbi pasuritë e të cilëve mund të veprojnë ligji

parandalues, **barra e provës për të justifikuar burimin e krijimit të tyre dhe ligjshmërinë e pasurive**, kalon nga Prokurori tek këta subjekte.

Pra si nga fryma e këtij ligji, por edhe nga interpretimi që i ka bërë Gjykata Kushtetuese ligjit parandalues, për rastin e pasurive të subjekteve për të cilët plotësohet kushti i parashikuar nga neni 24/1/”a”b” e 24 pika 2/”c”, ky i fundit, ka detyrimin, që të paraqesin prova në gjykim për të përjashtuar tërësisht ose pjesërisht pasurinë nga veprimi i ligjit parandalues.

21. Gjykata sqaron se gjatë procedurës së këtij gjykimi u zbatuan procedura e parashikuar në nenin 22 të ligjit parandalues dhe palët patën aksesin e nevojshëm për të paraqitur prova e për të përmbushur detyrimin sipas ligjës.

23. Në të kundërt me sa është pretenduar nga i padituri D.L. ky shtetas është person i dënuar për kryerjen e veprës penale të “Moskallëzimit të krimin”, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal, por megjithëse ka ndryshuar cilesimi ligjor i vepres penale dhe kjo e fundit është jashtë fushës së zbatimit të këtij ligji, e pasi nga të dhënat që njoftojnë provat e marra gjatë procedimit pasuror të Prokurorisë për Krime të Rënda, ekziston një dyshim i fortë për fshehje të origjinës së parave të fituara e te padeklaruara në momentin e depozitimit në xxx Bank, të depozituara në dy llogari bankare te vecanta me një vlerë shume të madhe krijuar në të njëjtën ditë, x prill xxx, dhe që në mënyrë të dukshme nuk i përgjigjen nivelit të të ardhurave dhe fitimeve të deklaruar nga ky shtetas apo të ekzistojë e dokumentuar kjo, ndaj i takon të paditurit D.L. të provoje justifikimin e tyre, konform ligjit të posacëm.

Prej të paditurit janë paraqitur pasqyrat e tërheqjes nga Bankat përkatëse të nivelit të dytë sikundër nga Bankat xxx Bank;xxx;xxx Bank; xxx Bank;xxx Bank; Banka xxx; Banka xxx;xxx Bank;Banka xxx, si dhe disa “mandat arketime” e “mandat pagese”.

Por, që nga pohimi i vetë të paditurit D.L. si dhe nga aktet ne dosje rezulton të ketë vepruar ne cilësinë e administratorit të shoqërisë private përmbarimore ‘xxx’, për të cilën dhe i është derdhur paga në një llogaritë bankare te sekuestruara.

Për më tepër, nga analiza e veprimeve financiare”Debi”-“Kredi”-“Balance” të kryera pranë bankave lartpërmendur, në kuadër të veprimtarisë ‘xxx’, ku pasqyrohen dhe veprimet financiare të personave te kontraktuar prej kesaj shoqërie per kryerjen e sherbimit përmbarimor në”Statement” të veprimtarisë së tij pranë xxx nga i padituri D.L. megjithë pasqyrat financiare të paraqitura, gjykata cmon se në asnjë nga Bankat sipërcituar i padituri të ketë kryer veprime tërheqjeje të afërta në kohë që të përkojnë me vlerat e shumave të depozituara në të njëjtën ditë në dy llogari të ndryshme të shumave vecmas prej xxx(xxx) Euro e në një kohë që në llogarinë rrjedhëse atij i kalon paga si administrator, pretendohet prej tij qe tërheqjen e fitimeve si “ortak”ta kete kryer drejtperdrejt nga Shoqëria.

Megjithëse nga i padituri është paraqitur vendimi i ndarjes së dividendit nëpërmjet vendimit Nr x të marrë më datë xxx, per fitimet e vitit xxx, gjithsesi duke iu referuar dhe aktit te ekspertimit kontabel, kjo shumë nuk i korespondon atyre te llogarive te krijuara prej xxx euro secila. Ndërsa sa i përket pretendimit se ai ka tërhequr ne kohe të ndryshme”paradhënie” fitimin e vitit xxx, **rezulton e provuar se** ndarja e ketij fitimi është kryer në bazë te vendimit nr x datë xxx të Asamblesë së Ortakëve dhe tatimi mbi

dividentin gjithashtu është paguar më datë xxx, kryer nëpërmjet transfertave, pra në një periudhë të mevonshme nga data e depozitimit të këtyre dy shumave në llogaritë përkatëse.

Ndonëse nga i padituri janë paraqitur ndër të tjera dhe dy fatura mandat pagese, me shënimin vetëm se janë tërhequr si rrjedhojë e ndarjes së dividentit në shumën prej xxx lekë dhe xxx Euro në të njëjtën datë xxx, këto dy mandate, gjykata i konsideron se nuk përmbushin ekstremitetet e proves në kuptim të nenit 11 e vijues të K.Pr.Civile. Gjykata nuk bindet për kryerjen e një veprimi të tillë financiar i pretenduar si **“terheqje paraprakisht të dividentit të vitit xxx nga ”xxx”** pasi jo vetëm që ato janë **“kryer”** para se të përcaktohej shuma e dividentit nga Asambleja e Ortakëve më datë xxx, por dhe këto mandat pagesa nuk mbështeten në ndonjë akt/dokument apo të **kenë lënë “gjurme” transferte bankare**, si dhe nuk pasqyrojnë asnjë të dhënë tjetër se **nga, ku dhe kush janë marrë apo dhënë këto shuma**, (madje as nënshkrimi i terheqësit D.L. nuk është vënë), ndërkohë që shifra e pasqyruar në të është shumë herë më e konsiderueshme nga cdo veprim tjetër i kryer nga shoqëria apo vetë i padituri D.L. si administrator i saj në tërheqjet nga Bankat përkatëse, ku mbaheshin llogaritë në emër të “xxx”, në një periudhë të afërt me kohën e depozitimit, xxx.

24. Për më tepër nga i padituri nuk u paraqit ndonjë provë tjetër mbi disponimin real të këtyre shumave, dhe për Gjykatën nuk është bindës as pohimi i të paditurit se dividenti i vitit xxx, ndërkohë që për këtë është **konkluduar** vetëm me **vendimin nr x e datës xxx** pas përpilimit të pasqyrave financiare (gati dy muaj pas arrestimit të të paditurit) ende pa u përcaktuar vlera totale e dividentit të jetë tërhequr paraprakisht e ndërkohë që të gjitha veprimet e tjera kryhen nëpërmjet Bankës dhe i padituri ka patur në emër të tij Llogari Bankare të celura paraprakisht, këto veprime, për këto shuma të konsiderueshme pretendohet se janë kryer në **“cash”**, që më pas janë **“depozituara”**, personalisht nga i padituri D.L. në llogaritë me numër nr. xxx dhe nr. xxx, pranë xxx Bank.

25. Gjithashtu nuk u paraqit nga i padituri asnjë provë **“exchange”** e veprimit financiar nga Lekë (ALL) të pretenduara se janë tërhequr e ndërkohë që fitimi i Shoqërisë përllogaritet në lekë shqiptare, nuk provohet **“exchange”** në Euro të depozituara në dy llogaritë lartpërmendur.

Për të gjitha sa më lart, në vlerësimin e gjykatës, nënkupton se niveli i dyshimeve dhe i provave në ngarkim të tij, tejkalon përcaktimin ligjor **“dyshim i arsyeshëm të bazuar në indicie”**, parashikuar në nenin 3 prg 1 të ligjit parandalues.

26. Pra përfundimisht, Gjykata për Krime të Rënda, vlerëson se *i gjykuari D.L. është subjekt i ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”*. Në nenin 3/1 të këtij ligji përcaktohet shprehimisht se dispozitat e tij zbatohen ndaj personave mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në indicie: **“...ç) kryerjen e krimeve të parashikuara nga nenet 109,109/b.....283/a dhe 284/a të Kodit Penal”** e në referim të nenit 24 pika 2 germa **“c”** të këtij Ligji. **Pra, shtetasi D.L. është subjekt i ligjit “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave**

parandaluese kundër pasurisë”.

27. Kjo Gjykatë në respektim të parimit të barrës së provës, të parashikuar në pikën 3, të nenit 21 të ligjit parandalues, sipas të cilit: “3. *Barra e provës, për të vërtetuar se pasuritë janë fituar në mënyrë të ligjshme, i përket personit, kundër pasurive të të cilit kërkohet konfiskimi.*”, në lidhje me provimin e prejardhjes së ligjshme të një pjesë të pasurisë së palës së paditur.

28. Në vlerësim të “Gjykatës” mbi justifikimin e ligjshmërinë të pasurive të zotëruara, i padituri nuk arriti të provojë si të ardhura të ligjshme shumën apo dhe as zotërimin e ndonjë pasurie tjetër nga e cila të mund të buronte ndonjë e ardhur e tillë për tu depozituar në shumën prej xxx (njëqind mijë) euro që ndër të tjera janë objekt konfiskimi në këtë gjykim.

29. Ndërkohë, dhe pse pala e paditur pretendoi të kishte ushtruar aktivitet si përmbaues gjyqësor privat në Shoqërinë ‘xxx’, provat e paraqitura prej tij e konkretisht pasqyrat financiare apo dokumente të tjera të ligjshme për të provuar të ardhurat e fituara në mënyrë të ligjshme dhe të deklaruara në organet tatimore, siç kërkon në mënyrë eksplicite neni 24/1-b i ligjit parandalues “...*nivelit të të ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të ligjshme, të deklaruara ...*” nuk ishin të mjaftueshme për gjykatën për të krijuar bindjen mbi ligjshmërinë e krijimit të kësaj shume prej të paditurit në masën prej xxx (xxx) euro, në zotërim të plotë të tij.

30. I padituri, edhe pse provoi që kishte ushtruar aktivitet të regjistruar në tatime si avokat e përmbaues gjyqësor privat si dhe bashkëshortja e tij me aktivitet ne profesion te lire si avokate e notere ata kishin depozituar bilancet e paguar tatim fitimin, por nuk provoi kushtin bazik që kërkon ligji parandalues, se me çfarë të ardhurash dhe nga çfarë burimesh të ligjshme ata kishin siguruar mjetet e nevojshme monetare të depozituara, për të krijuar në një periudhë aq të shkurtër dy llogaritë bankare prej 50 mijë euro vetem në muajin prill xxx, duke mos qenë aspak bindës për gjykatën se keto janë pjesë e fitimit te vitit ushtrimor xxx të Shoqërisë ”xxx”.

31. Pjesërisht i paprovuar mbeti në çmim të kësaj Gjykate pretendimi i palës së paditur L. në lidhje me të ardhurat e realizuara nga kjo palë nga aktiviteti i bashkëshortes G.N., ne raport me shumat prej xxx (xxx) euro të depozituara në prill xxx nga i padituri D.L., për të cilat cmohet nga Gjykata se duhet te vendoset konfiskimi i tyre, kjo duke iu referuar dhe minibilanceve të depozituara në organet tatimore, në referim të nenit 24/1-b të ligjit parandalues.

32. Siç u analizua më sipër, në këtë gjykim pala e paditur e mbrojtësi prapësuan tërësisht pretendimet e palës kërkuese, Prokurorisë për Krime të Rënda, për konfiskimin e pasurive objekt gjykimi, duke paraqitur para gjykatës prova për të justifikuar pasuritë (e luajtshme) dhe burimin e krijimit të tyre, si rrjedhojë e përfitimit të pagës nga puna e tij si përmbaues

shtetëror, si avokat dhe si administrator i shoqërisë xxx group apo si një nga tre ortakët e kësaj shoqërie(në raportin prej 33% të aksioneve), duke pretenduar gjithashtu dhe të ardhurat e fitimet e krijuara nga bashkëshortja e tij G.N. në ushtrimin e profesionit të lirë si xxx, prova të cilat në tërësi vlerësohen nga **Gjykata duke e cuar atë në bindjen se padia e paraqitur duhet pranuar pjesërisht**, pasi, në çmim të kësaj Gjykate, pala e paditur, nuk arriti të justifikonte me të ardhura të ligjshme burimin e krijimit të të gjitha llogarive që disponoheshin nga i padituri D.L., ndaj në respektim të të nenit 24/1 e 24/2 të ligjit parandalues, kjo gjykatë vendos të kryejë konfiskimin e pjeshëm të vlerave monetare (konkretisht për dy llogarite me nga xxx euro), në zotërim të drejtpërdrejtë të të paditurit D.L., të dyshuar për pjesëmarrje në veprimtari kriminale, sipas parashikimeve të nenit 24/2/c e nenit 3 të ligjit parandalues 10192 datë 03.12.2009

33. Por, ndryshe nga pala paditëse, prokuroria për Krime të Rënda, **Gjykata vlerëson** se i padituri D.L. dhe familja e tij i kanë pasur mundësitë që të kishin gjëndje dhe të dispononin në llogaritë e Bankës xxx (sipas vertetimit të lëshuar nga xxx Bank se ne llogarinë **nr xxx** me emërtimin ‘‘llogari page në sektorin privat) që ndodhej shuma prej **xxx lekë** pra që ishte dhe llogaria në të cilën derdhej paga e të paditurit nga puna si administrator i ‘xxx’ si dhe për shumat prej **xxx USD si dhe xxx euro dhe xxx lekesh**, duke marrë në konsideratë në raport me provat e paraqitura edhe aktin e ekspertimit kontabel(atë përfundimtar datë xxx) mbi të ardhurat, shpenzimet e fitimet/kursimet ndër vite duke filluar nga xxx (kërkuar kjo si periudhë nga pala e paditur) deri në datën e arrestimit të të hetuarit D.L. xxx gjykata vlerëson se për këto shuma duhet të rrëzohet kërkesa/padia për konfiskimin e tyre, prandaj pretendimi i Prokurorisë për Krime të Rënda për konfiskimin e këtyre vlerave monetare, nuk mund të pranohet duke u gjetur si të justifikuar ligjerisht të krijuara këto shuma, e mbështetur dhe në prova.

34. Në këto kushte duke e gjetur si të pambështetur kërkimin nëpërmjet padisë për konfiskimin e shumave monetare ndodhur ne llogarite me nr. xxx e me nr.xxx si dhe të shumave të sekuestruara në banesë në momentin e arrestimit datë xxx prej xxx euro dhe xxx lekë, meqenëse prokurori nuk arriti të provonte që kjo pasuri përbënte produkt të veprimtarisë kriminale të të gjykuarit, në kuptim të nenit 36 të Kodit Penal dhe nenit 190 të K.Pr.Penale, gjykata cmon që konform ligjit nr 10192 datë 03.12.2009, të shprehet dhe mbi revokimin e pjeshëm të vendimit të sekuestrimit të gjykatës nr xx datë xxx, mbi shumat në llogaritë e sipërcituara konform këtij ligji.

Gjykata cmon se shpenzimet gjyqësore procedurale, konform nenit 25 të Ligjit 10192 datë 03.12.2009, si dhe mbështetur në nenin 104;105;105/a të K.Pr.Civile, duke perfshire dhe pagesën e ekspertit në referim të Udhëzimit të Këshillit të Ministrave me nr 4 datë 12.12.2012’’Për caktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor’’ në masën prej xxx (xxx) lekë, i ngarkohen të paditurit D.L.

35. Qëllimi i ligjit parandalues është shprehur qartë në nenin 2 të tij: ‘‘...parandalimi dhe goditja ndaj krimit të organizuar dhe trafikimit përmes konfiskimit të pasurisë së personave, të cilët kanë një nivel të pajustificuar ekonomik, si rezultat i veprimtarisë së dyshuar kriminale.’’ ky ligj synon të vërë në zbatim një sërë masash me natyrë parandaluese e

goditëse kundër pasurive të pajustificuara ligjërisht që iu përkasin një kategorie të veçantë personash me rrezikshmëri të madhe shoqërore, për shkak të kryerjes prej tyre të veprave penale të rënda.

36. Gjykata si dëgjoi pretendimet e palëve në gjykim dhe shqyrtoi e ia nenshtroi hetimit gjyqësor provat e aktet zyrtare, konkludon në bazë të nenit 126, 302, 309, 310 të K.Pr.Civile si dhe neneve 3, 5, 7, 13, 21, 22, 23, 24, 28 e vijues të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”,

PËR KËTO ARSYE

Gjykata bazuar në nenet 3, 5, 7, 13, 21, 22, 23, 24, 28 e vijues, të ligjit nr.10192 datë 03/12/2009 “Për parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”, si dhe në nenet 302, 309 dhe 310 të Kodit të Procedurës Civile:

V E N D O S I:

-Pranimin pjesërisht të kërkesës së Prokurorisë për Krime të Rënda Tiranë duke vendosur:

Konfiskimin e pasurive të mëposhtme:

1)-Ne Llogarinë me nr. xxx të shumes xxx(xxx) euro

2)-Në Llogarine me nr. xxx të shumes xxx(xxx) euro, të depozituara njëherësh në datë xxx, **në emër të D.L. pranë xxx Bank e kalimin në favor të shtetit.**

-Rrezimin e pjesshëm të padisë duke revokuar pjesërisht vendimin nr xx datë xxx të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, mbi shumat e ndodhura ne:

1)-Llogarine me nr. xxx të shumes xxx(xxx) leke pranë Bankës xxx;

2)-Llogarine me nr. xxx të shumes xxx(xxx) USD(dollarë amerikanë) pranë Bankës xxx;

3)-Të shumave të sekuestruara në banesë datë xxx prej xxx(xxx) euro dhe xxx lekesh që gjenden ne Bankën xxx, me nr llogarie xxx, xxx dhe në Bankën xxx me nr llogarie xxx, **e kthimin e tyre në favor të të paditurit D.L.**

-Shpenzimet gjyqësore, sipas formularit bashkëngjitur këtij vendimi, përfshirë dhe pagesën e ekspertit në masën prej xxx (xxx) lekë, i ngarkohen të paditurit D.L.

-Kunder këtij vendimi lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë sipas afatit ligjor brenda 15(pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e shpalljes.

U shpall sot ne Tiranë më datë 09.05.2014 ora 13.25.

SEKRETARE

Blerina SUKAJ

GJYQTARE

Nertina KOSOVA